



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), si dhe neneve 26 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2019, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR DREJTORËT DHE MENAXHERËT E LARTË TË BANKAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i standardeve “i përshtatshëm dhe i duhur” dhe i kriterëve të pavarësisë, për miratimin fillestar të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë nga BQK-ja, të propozuar si pjesë e procesit të licencimit dhe përshtatshmërisë së tyre në vazhdimësi.
2. Kjo rregullore gjithashtu përcakton kufizimin e nivelit të aksioneve që drejtorët e pavarur mund të zotërojnë drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte në bankë, në mënyrë që të ruhet pavarësia e tyre siç është rregulluar me nenin 26 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për Bankat*).
3. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja, përveç neneve 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, të cilët nuk aplikohen për degët e bankave të huaja siç është përcaktuar me paragrafit 4 të nenit 26 të Ligjit për bankat.

Neni 2

Përkufizimet

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohen në nenin 3 të Ligjit për bankat.

Neni 3

Kriteret 'i përshtatshëm dhe i duhur' për drejtorët dhe menaxherët e lartë

1. BQK-ja i kushton rëndësi të veçantë përshtatshmërisë së drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të propozuar të bankës përgjatë gjithë procesit të licencimit dhe mbikëqyrjes së bankave.
2. BQK-ja i përdorë kriteret e mëposhtme, përveç kërkesave të nenit 35 të Ligjit për bankat, për të bërë vlerësimin para se të japë miratimin e saj për çdo individ sipas paragrafit 3.4 të nenit 8 të Ligjit për bankat:
 - 2.1. **Integriteti.** Historia personale e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të mundshëm duhet të dëshmojë se ata janë plotësisht të pavarur dhe se posedojnë kualitete personale, në rend të parë integritetin që është i nevojshëm për t'i kryer detyrat e tyre;
 - 2.2. **Gjykimi i shëndoshë.** Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë kualifikimet e duhura formale dhe aftësi personale që i japin mundësi atyre, që në mënyre kritike dhe adekuate të vlerësojnë politikat e rëndësishme dhe çështjet strategjike, me të cilat do të ballafaqohet banka dhe të artikulojnë qartë pikëpamjet e tyre mbi çështjet e tilla;
 - 2.3. **Udhëheqja.** Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë përvojë të mjaftueshme të udhëheqjes në biznes siç kërkohet me aktet juridike në fuqi;
 - 2.4. **Kompetenca.** Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë diplomë universitare në ekonomi, financa dhe jurisprudencë ose fushë tjetër relevante. Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë së paku pesë vite përvojë në njërin nga fushat e cekura me sipër në këtë nënparagraf. Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për obligimet që marrin dhe ju besohen dhe që ata propozojnë t'i kryejnë për të mirën e interesave të depozitorëve, si dhe të kornizës ligjore sipas të cilës operojnë bankat në Kosovë;
 - 2.5. **Qëndrueshmëria financiare.** Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të dëshmojnë përmbushjen e shpejtë të obligimeve të kaluara financiare dhe gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare.
3. Përveç materialit të shkruar, BQK-ja në raste të veçanta mund të kërkojë të intervistojë individin në fjalë. BQK-ja gjithashtu vlerëson përshtatshmërinë e bordit të drejtorëve si të tërë dhe jo vetëm anëtarët individual të tij. Po ashtu BQK-ja vlerëson kompetencën e ekipit të menaxhmentit të lartë, si dhe nëse çdo anëtar i tij është i përshtatshëm dhe i duhur.
4. I njëjti proces i kërkesave dhe vlerësimit do të ndiqet kurdoherë që një drejtor apo menaxher i ri propozohet nga një bankë ekzistuese.
5. Siç theksohet në nenin 35, paragrafi 4, të Ligjit për bankat është përgjegjësi e bankës për të njoftuar BQK-në, nëse mëson për ndonjë arsye pse një drejtor ose menaxher i lartë mund të mos jetë më i përshtatshëm dhe i duhur në pajtim me Ligjin për bankat dhe kriteret e lartpërmendura.

6. Nëse BQK-ja konstaton se një menaxher i lartë ose drejtor nuk është i përshtatshëm dhe i duhur, atëherë BQK-ja do të diskualifikojë individin në bazë të nenit 36 të Ligjit për bankat dhe do të sigurojë largimin e individit nga detyra.
7. Dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me drejtorët nuk janë të aplikueshme për degët e bankave të huaja, përveç kërkesave lidhur me menaxherët e lartë të cilat aplikohen edhe për degët e bankave të huaja.

Neni 4

Pavarësia lidhur me përgjegjësitë e drejtorit

1. BQK-ja kërkon që përbërja e bordit të drejtorëve të jetë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 26 të Ligjit për bankat.
2. Sipas paragrafit 1 të nenit 26 të Ligjit për bankat, kryeshefi ekzekutiv, nuk ka të drejtë vote në bordin e drejtorëve dhe nuk llogaritet si anëtar në përbërjen e bordit të drejtorëve. Asnjë zyrtarë tjetër i ekzekutivit apo i stafit të bankës në Kosovë nuk mund të jetë anëtarë i bordit të drejtorëve të bankës.
3. BQK-ja ka të drejtën e përcaktimit të pavarësisë së një drejtori të propozuar të një banke në pajtim me paragrafin 3 të nenit 26 të Ligjit për bankat. BQK-ja do të përdorë kriteret në vijim për vlerësimin e pavarësisë së individit para se të japë aprovimin lidhur me paragrafin 3 të nenit 26 të Ligjit për bankat:
 - 3.1. **Gjykimi.** Individit duhet të jetë i aftë të demonstrojë posedimin e gjykimit të shëndoshë dhe ushtrimit të gjykimit të tij për të mirën e bankës në Kosovë;
 - 3.2. **Mungesa e konfliktit të interesit.** Individit duhet të jetë i aftë të demonstrojë se aktualisht nuk ka ndonjë konflikt të perceptuar apo aktual të interesit ndërmjet rolit të tij si drejtorë i bankës dhe ndonjë roli biznesor apo personal që ai bartë. Kjo kërkesë duhet të përmbushet përgjatë gjithë mandatit të individit si drejtor i bankës;
 - 3.3. **Nuk është subjekt i ndikimit dhe kontrollit nga të tjerët.** Individit duhet të jetë i aftë të demonstrojë se nuk do të jetë subjekt i kontrollit apo ndikimit të papërshtatshëm nga të tjerët gjatë marrjes së vendimeve si drejtor i bankës; dhe
 - 3.4. Ndonjë kriter apo fakt tjetër që BQK-ja mund të parashtrojë dhe vlerësojë si relevant.
4. Përveç materialit të shkruar, BQK-ja mund të kërkojë edhe të intervistojë individin në fjalë.
5. Është përgjegjësi e bankës për të njoftuar BQK-në nëse mëson për ndonjë arsye pse një drejtor i caktuar si drejtor i pavarur mund të mos i përmbushë më kriteret e pavarësisë së drejtorëve.

Neni 5
Kufizimi për zotërimin e aksioneve

1. Neni 26, paragrafi 3 i Ligjit për banka, u lejon drejtorëve të pavarur të posedojnë aksione në bankën në bordin e të cilës ata shërbejnë, por në nivel të kufizuar, për të ruajtur pavarësinë e tyre. Si shumë kompani që u kërkojnë drejtorëve të mbajnë aksionet në kompaninë nga e cila janë zgjedhur është e arsyeshme që t’iu lejohet posedimi i aksioneve të bankës të gjithë drejtorëve të bankave. Megjithatë, kufizimi duhet të jetë i ulët në nivel të mjaftueshëm, në mënyrë që të sigurohet pamundësia e konfliktit të interesit.
2. Në pajtim me paragrafin 3 të nenit 26 të Ligjit për banka, BQK-ja përcakton që asnjë drejtor i pavarur, së bashku me çdo individ të ndërlidhur, nuk mund të mbajë drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se një (1) përqind të çdo klase të aksioneve me të drejtë vote ose të kapitalit në dobi të një banke ose të ndonjë kompanie aksionare të grupit pjesë e të cilit është banka.

Neni 6
Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe suspendimeve në pajtim me nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për bankat.

Neni 7
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Bankave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 9 nëntor 2012.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datën 1 gusht 2019.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës